



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE
KRIMIT TË ORGANIZUAR**

Nr. 1093 Prot.,

Tiranë, më 11. 11. 2024

UDHËZIM I PËRGJITHSHËM

1093

Nr. __, datë 11. 11. 2024

PËR

**MASAT ADMINISTRATIVE DHE PROCEDURALE PËR KRYERJEN E
HETIMIT FINANCIAR DHE PASUROR NË STRUKTURËN E POSAÇME
KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR**

Në mbështetje të nenit 148 dhe 148/dh të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të shkronjave “e” dhe “ë” të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 95/2016 “Për *organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar*”, i ndryshuar,

U D H Ë Z O J:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi, standartizimi dhe unifikimi i mënyrës së ndjekjes së procedurave penale të ndërmarra nga prokurorët e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (në vijim Prokuroria e Posaçme), hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit (në vijim BKH) dhe nga hetuesit e Sektorit të Hetimit Financiar (në vijim SHF), gjatë kryerjes së hetimit financiar dhe pasuror.

Neni 2

Objekti

1. Objekt i këtij udhëzimi të përgjithshëm janë veprimet procedurale të prokurorëve dhe hetuesve gjatë kryerjes së hetimeve financiare dhe pasurore për pasuritë, produkt i veprës penale ose veprimtarisë kriminale, në kompetencë lëndore të Prokurorisë së Posaçme, si në zbatim të Kodit të Procedurës Penale (në vijim K.Pr.P.), ashtu dhe në zbatim të ligjit nr. 10192/2009 *“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”*, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 10192/2009).

KREU II

ROLI DHE PËRGJEGJËSIA E PROKURORIT

Neni 3

Objektivat e Hetimit

Objektivat që duhet të ndiqen për masat e përdorura kundër produkteve të veprave penale duhet të shtrihen në tre dimensione:

- a) konfiskimi i produkteve të veprës penale;
- b) konfiskimi i vlerës ekuivalente;
- c) masat e sekuestrimit dhe konfiskimit me anë të ligjit nr. 10192/2009.

Neni 4

Kompetenca lëndore

1. Prokurori i Prokurorisë së Posaçme (në vijim prokurori) kryen hetime me qëllim identifikimin dhe konfiskimin e produkteve të veprave penale për të cilat ai ushtron kompetencë lëndore sipas nenit 75/a të K.Pr.Penale.
2. Prokurori kryen gjithashtu verifikimin dhe regjistron hetimin pasuror, për veprat penale në kompetencën e saj lëndore të cilat parashikohen në ligjin nr. 10192/2009.

Neni 5

Detyrat e prokurorit

1. Prokurori është përgjegjës për drejtimin dhe koordinimin e hetimeve financiare dhe pasurore. Këto përgjegjësi përfshijnë, por nuk kufizohen në mbikëqyrjen dhe mbledhjen sistematike dhe metodike të provave, përfshirë dokumentacionin financiar, regjistrat bankarë, dhe çdo lloj të dhëne që kontribuon në identifikimin dhe verifikimin e aktiviteteve të dyshuara si të paligjshme.
2. Në kryerjen e funksioneve si më sipër mbahet parasysh:
 - a) përcaktimi i drejtimit strategjik të hetimit, duke vendosur objektivat kryesore të hetimit dhe prioritetet në përputhje me nevojat e hetimit të çështjes;
 - b) koordinimi dhe ndërveprimi me hetuesit e BKH-së dhe hetuesit e SHF-së duke përcaktuar qartë rolet dhe përgjegjësitë e secilit anëtar të ekipit;
 - c) sigurimi që provat të mblidhen në respektim të procedurave dhe standardeve ligjore dhe etike, duke mbrojtur të drejtat e të dyshuarve dhe palëve të treta;
 - ç) garantimi i respektimit të legjislacionit në fuqi dhe standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut gjatë kryerjes së veprimeve hetimore dhe ndjekjes penale, përfshirë mbrojtjen e të drejtave të të gjitha palëve të përfshira si të dyshuarit, viktimat dhe dëshmitarët;
 - d) vlerësimi i vazhdueshëm i provave të disponueshme për të përcaktuar drejtimin efikas të hetimit;
 - dh) dokumentimi i të gjitha vendimeve dhe veprimeve të kryera gjatë hetimit dhe ndjekjes penale.

Neni 6

Koordinimi i hetimit

1. Prokurori kryen hetimin pasuror dhe financiar në koordinim dhe bashkëpunim të ngushtë me hetuesin e BKH-së dhe hetuesin e SHF-së, të caktuar me urdhër të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, të cilët ndihmojnë prokurorin gjatë punës së tij.
2. Në rastin e hetimeve komplekse, prokurori i çështjes mund të urdhërojë më shumë se një hetues për kryerjen e veprimeve hetimore të caktuara me urdhër apo delegim të këtij të fundit. Në këtë

rast, hetuesit e tjerë ia përcjellin prokurorit informacionin e mbledhur respektivisht nëpërmjet hetuesit të BKH-së, apo hetuesit të SHF-së, të caktuar sipas pikës 1, të këtij neni. Këta të fundit, janë përgjegjës për mbledhjen, analizimin dhe sintetizimin e informacionit të mbledhur nga hetuesit e tjerë, sipas urdhrave dhe delegimeve të prokurorit.

KREU III

HETIMI FINANCIAR PARALEL

Neni 7

Fillimi i hetimit pasuror dhe financiar

1. Gjatë zhvillimit të hetimeve penale, në mënyrë paralele kryhet edhe hetimi financiar ose pasuror për personat e dyshuar për kryerjen e veprave penale, të cilat gjenerojnë të ardhura pas identifikimit të subjektit dhe ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm për veprën penale. Në raste të veçanta, kur vlerësohet e nevojshme për të ruajtur “sekretin hetimor” të hetimit penal, hetimi pasuror apo veprime të caktuara të hetimit pasuror mundet të kryhen në një moment të mëvonshëm.
2. Hetimi financiar nuk kufizohet vetëm tek autorët e veprës penale, por duhet të zgjerohet edhe tek persona të tretë, pavarësisht nëse janë individë ose subjekte, të cilët me veprimet e tyre tentojnë të justifikojnë ligjërisht të ardhurat e fituara nga veprimtaria kriminale.
3. Rezultatet e hetimit financiar, sipas rastit, integrohen me ato të hetimit penal, ose të hetimit pasuror.
4. Në përfundim të hetimit financiar, kur është e mundur, prokurori duhet të identifikojë dhe të përfshijë në akuzën e ngritur vlerën specifike të parave ose të ardhurave, si edhe numrin dhe llojin e aseteve të fituara në mënyrë kriminale.
5. Në përfundim të hetimeve penale, prokurori nëse vlerëson se ekzistojnë kushtet për kryerjen e hetimeve të mëtejshme pasurore, regjistron referimin pasuror dhe vijon me kryerjen e verifikimeve pasurore sipas ligjit nr. 10192/2009. Nëse këto kushte nuk ekzistojnë, aktet e hetimit financiar mbeten pjesë e akteve të fashikullit të hetimit penal.

Neni 8

Hetimi pasuror

1. Prokurori, brenda 30 ditëve nga mbërritja/regjistrimi i materialit të verifikimit paraprak nga policia gjyqësore e strukturës hetimore të posaçme nga Policia e Shtetit, hetuesit e BKH-së, ose hetuesit e SHF-së, bazuar në aktet e referuara, verifikon dhe vlerëson ekzistencën e elementeve thelbësore të faktit dhe kushteve e kriterëve ligjore sipas përcaktimit në nenin 3 të ligjit nr. 10192/2009, dhe vendos:

- a) Në rastet kur prokurori vlerëson se nuk ka të dhëna, indicie ose akte/dokumente që evidentojnë elemente thelbësore të faktit për zbatimin e ligjit nr. 10192/2009, ose nuk ka pasuri për të cilat mund të kërkohet aplikimi i masave parandaluese pasurore vendos kthimin e akteve për plotësim ose arkivimin e materialit referues.
 - b) Në rastet kur ka të dhëna, indicie ose akte/dokumente për personat dhe pasuritë që evidentojnë elementet thelbësore të faktit për zbatimin e ligjit nr. 10192/2009, ose ka pasuri për të cilat mund të kërkohet aplikimi i masave parandaluese pasurore, prokurori regjistron referimin pasuror dhe urdhëron kryerjen e verifikimeve paraprake pasurore.
 - c) Në rastet kur prokurori vlerëson se nuk ka kompetencë shpall moskompetencën dhe përcjell aktet prokurorisë kompetente.
2. Me regjistrimin e referimit pasuror, prokurori dhe policia gjyqësore kryejnë të gjitha verifikimet e mundshme dhe të nevojshme pasurore sipas kërkesave të neneve 3, 5, 6, 8 dhe 9 të ligjit nr.10192/2009.
 3. Verifikimet pasurore duhet të përfundojnë brenda afatit të arsyeshëm për përfundimin e tyre, në varësi të nevojave për kryerjen e verifikimeve pasurore, marrëdhënies me masat e sigurimit pasurore të vendosura në kuadër të procedimit penal, si dhe kompleksitetit të verifikimeve pasurore.
 4. Gjatë verifikimeve pasurore ose në përfundim të tyre, prokurori vlerëson nëse ekzistojnë kushtet për vendosjen e masave parandaluese pasurore sipas ligjit nr. 10192/2009, dhe nëse këto kushte ekzistojnë, procedon me regjistrimin e procedimit pasuror.
 5. Nëse në përfundim të verifikimeve pasurore, prokurori vlerëson se nuk ekzistojnë kushtet për vendosjen e masave parandaluese pasurore sipas ligjit nr. 10192/2009, atëherë vendos mosfillimin e procedimit pasuror.
 6. Me fillimin e procedimit pasuror, prokurori mundet të paraqesë kërkesë për vendosjen e masës së sekuestrimit të pasurisë, sipas nenit 11 e vijues të ligjit nr.10192/2009, dhe kërkesë për konfiskimin e pasurisë, sipas nenit 21 e vijues të këtij ligji.
 7. Afatet e procedimit pasuror janë të njëjta me afatin e kohëzgjatjes së masës së sekuestrimit të pasurisë.
 8. Në përfundim të procedimit pasuror, jo më vonë se 5 (pesë) ditë para përfundimit të afatit të kohëzgjatjes së masës së sekuestrimit të pasurisë, ose para përfundimit të afatit të zgjatur të masës së sekuestrimit të pasurisë, nëse ekzistojnë kushtet e parashikuara në ligj, prokurori procedon me kërkesë për konfiskimin e pasurisë.
 9. Nëse nuk ekzistojnë kushtet e parashikuara në ligj për konfiskimin e pasurisë, brenda afatit të parashikuar në pikën (7) të këtij neni, prokurori procedon me kërkesë drejtuar Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për revokimin e sekuestrimit të pasurisë.
 10. Drejtuesi i Prokurorisë mund t'i kërkojë prokurorit të çështjes informacion me qëllim verifikimin e rregullshmërisë dhe vijueshmërisë së kryerjes së veprimeve në kuadër të hetimit pasuror.

Neni 9

Plani i hetimit

1. Prokurori në përputhje me natyrën dhe veçoritë e çdo procedimi penal në fazën e hetimit, si dhe në përputhje me veçoritë e hetimit pasuror paralel, planifikon mënyrën e hetimit duke përfshirë edhe kryerjen e hetimit financiar. Në planifikimin e hetimit financiar dhe të hetimit pasuror përfshihen këto elementë:

- a) vendosjen e prioriteteve bazuar në rëndësinë e çështjes, provat ekzistuese, dhe burimet në dispozicion;
- b) përcaktimi i rolit dhe delegimi i detyrave të hetuesit të BKH-së dhe hetuesit të SHF-së;
- c) identifikimin e objektivave specifike që duhen arritur, siç janë zbulimi i pasurive të pajustificuara ligjërisht produkt i veprës penale, burimeve të pasurive të paligjshme, i formave dhe mënyrave të përfitimit të të ardhurave të paligjshme, i personave apo strukturave që ndihmojnë ose mundësojnë fshehjen apo pastrimin e pasurive të paligjshme, dokumentimi i lidhjeve financiare midis subjekteve të dyshuara dhe aktivitetit kriminal, etj.;
- d) identifikimin e institucioneve që posedojnë të dhëna të vlefshme për çështjen nën hetim;
- e) identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve dhe sfidave të mundshme që mund të hasen gjatë hetimit, duke përfshirë pengesat ligjore, kufizimet e burimeve dhe mundësitë e ndërhyrjes së palëve të treta, si dhe hartimin e një plani për menaxhimin e këtyre rreziqeve, që mund të përfshijë mbrojtjen e dëshmitarëve apo të të dhënave;
- f) mënyrën e mbledhjes së informacionit dhe ndërtimin e profilit financiar të individit nën hetim, duke përfshirë identifikimin e produkteve, të ardhurave dhe pasurive;
- g) mënyrën e mbledhjes së provave mbi produktet e identifikuar, të ardhurat, pasuritë (për p.sh. faturat, deklaratat bankare, vërtetime nga institucionet shtetërore, etj...);
- h) identifikimin e pronarit përfitues dhe mbledhjen e provave (kartat e debitit ose kreditit, automjetet në posedim real etj.);
- i) mënyrën e administrimit të provave të mbledhura, në veçanti provat me natyrë digjitale;
- j) identifikimin e ekspertëve të posaçëm të nevojshëm për të ndihmuar hetimet apo për të dëshmuar në gjyq.

2. Prokurori monitoron ecurinë e hetimit, vlerëson periodikisht strategjinë e hetimit dhe bën ndryshimet e nevojshme në varësi të ecurisë së hetimit të çështjes.

Neni 10

Profili financiar

1. Hetuesit ndërtojnë profilin financiar të personit nën hetim apo subjektit të masave parandaluese, me qëllim identifikimin e pasurive produkt të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, identifikimin e burimeve të fshehura të të ardhurave ose aktiviteteve të paligjshme, identifikimin e pasurive që mund të sekuestrohen dhe të konfiskohen. Profili financiar i një personi ndërtohet

duke analizuar dhe krahasuar pasuritë dhe mënyrën e pajustificuar të jetesës me të ardhurat e ligjshme.

2. Për të hartuar një profil financiar të saktë, analizohen elementët e mëposhtëm:

a) Pasuritë, të tilla por pa u kufizuar vetëm në to, si dhe mënyra e fitimit të pasurive si:

- pasuritë e paluajtshme të regjistruara, si dhe ato që zotërohen prej tyre në mënyrë indirekte;
- pasuritë e luajtshme të regjistruara si automjete, avione, jahte etj.;
- pasuri të luajtshme të identifikuar si bizhuteritë, veprat e artit ose objekte koleksioni, etj...;
- tituj dhe instrumente ligjorë që vërtetojnë tituj ose interesa të tjerë në pasuri;
- likuiditete si llogari bankare, aksione, kapital aksionar dhe obligacionet, paratë jashtë banke (shumë të holla parash);
- huatë dhe kreditë;
- mënyra, vendi i ruajtjes së vlerave monetare etj. dhe deklarimi apo jo në organet përkatëse (si në tatime, ILDKPKI);

b) Të ardhura por pa u kufizuar vetëm në to, si dhe mënyra e fitimit të të ardhurave, si:

- përfitime nga sigurimet e jetës, të pronës apo shëndetësore, përfitimet nga skemat private të pensioneve;
- shumat e fituara në kazino apo baste sportive;
- burime potenciale të ardhurash në të ardhmen nga të drejtat e kontestuar apo pretendimet për përmbushje detyrimesh nga të tretë;
- të ardhurat nga aktivitetet e pavarura;
- të ardhura nga bujqësia ose pemëtaria;
- dividendi, të ardhurat nga veprimtaria tregtare e individëve ose bashkëpunëtorëve informalë;
- të ardhurat nga aktivitetet e konsulencës;
- të drejtat e marra nga organizime familjare;
- të drejtat e pronësisë intelektuale;
- të ardhurat që rrjedhin nga prona (qiraja, interesi etj.);

c) Shpenzimet të tilla por pa u kufizuar në to, si edhe mënyra e kryerjes së tyre si:

- pagesat e qirasë;
- normat e *leasing*-ut;
- pagesat në dorë ose me kartë krediti;
- pagesat e huasë dhe kredisë;
- udhëtimet duke pasur parasysh qëllimin e tyre, kohëzgjatjen dhe vendin e akomodimit;
- shpenzimet e kryera për pushimet;
- tarifatat e shkollimit;
- pagesat e taksave;
- primet e sigurimit;

- detyrimi për ushqim (alimoni);
- paratë e shpenzuara në kazino ose në festa, etj.

3. Për çdo pasuri ose detyrim, nëse ekzistojnë dokumente që vërtetojnë këto elementë, duhet të identifikohen data e blerjes/transaksionit, personi nga i cili është blerë, ose për çfarë është bërë shpenzimi, qëllimi i tij, si është përdorur shuma e fituar, metoda e pagesës (në dorë, urdhër pagesë, transfertë bankare) dhe burimi i fondeve, garancitë e përdorura.

4. Pasuritë e subjektit në hetim duhet të përcaktohen jo vetëm duke identifikuar çmimet e referencës të përcaktuara me akte ligjore, siç është kostoja e shitjes së ndërtesave ose e automjeteve, të cilat shpesh përfshihen në kontratat e transferimit të pronësisë me një çmim të ulët. Nëse lind dyshimi për uljen e vlerës, hetuesi i SHF-së kryen një analizë për të përcaktuar vlerën e tregut të pasurive në pronësi ose përdorim nga individët në hetim.

Neni 11

Përparësia e hetimit financiar

1. Prokurori i jep përparësi hetimit financiar në rastet kur:

- a) Në çështjet ku, sipas hetimit, aktiviteti i paligjshëm përfshin vlera të konsiderueshme financiare, e cila ka një shtrirje të gjatë kohore;
- b) Në hetimet ku ekzistojnë indicie për shkelje të rënda financiare, duke përfshirë, por pa u kufizuar në pastrimin e produkteve të veprës penale, veprat penale që lidhen me korrupsionin e zyrtarëve të lartë publikë, krimin e organizuar dhe financimin e terrorizmit;
- c) Në hetimet që lidhen me çështje që kanë ndjeshmëri të lartë për publikun.

KREU IV

GJURMIMI I PRODUKTEVE TË VEPRËS PENALE DHE MBLEDHJA E PROVAVE

Neni 12

Metodat e gjurmimit

1. Për mbledhjen e informacionit të nevojshëm për të kryer hetime financiare ose pasurore, prokurori dhe hetuesi iu referohet këtyre burimeve kryesore:

- a) Informacioni nga burime të hapura;
- b) Informacioni nga bazat e të dhënave shtetërore dhe private. Një listë e bazave të të dhënave shtetërore gjendet bashkëlidhur në Shtojcën e këtij Udhëzimi;
- c) Informacioni nga agjencitë e ndryshme ligjzbatuese.

2. Për të mbledhur informacion nga burimet e hapura, prokurori dhe hetuesi përdor kryesisht motorët e kërkimit në internet. Informacionet e hapura përfshijnë llogaritë e krijuara në faqet e rrjeteve sociale, postimet në blogje, komente në forume *online*, profile në platforma profesionale si “LinkedIn”, galeritë e fotografive në internet, video të postuara në “YouTube” ose në platforma

të tjera të ndarjes së videos, dhe historitë e publikuara në media *online* ose portale lajmesh. Këto burime përdoren veçanërisht për të përcaktuar rrethin e interesave dhe miqve të individit që është subjekt i analizës, stilin e jetesës, vendet e argëtimit dhe rekreacionit, pasuritë e luajtshme ose të paluajtshme dhe automjetet që përdoren në të vërtetë, etj...

3. Nëse prokurori vlerëson se informacioni i pasqyruar në internet paraqet interes të lartë për hetimin e çështjes, dhe duke marrë në konsideratë nevojën për të paraqitur prova në gjykatë, për të konfirmuar të dhënat rreth përdoruesit të llogarisë, ai mund të kërkojë nga kompanitë përkatëse informacion rreth llogarisë elektronike.

4. Prokurori mund të kërkojë dhe mbledhë edhe informacion rreth komunikimeve me anë të postës elektronike (*e-mail*) të individëve ose organizatave nën hetim, të tilla si llogaria e përdorur nga personi dhe adresat IP nga të cilat janë dërguar ose marrë *e-mail*-et, korrespondenca e personit, personat me të cilët korrespondon personi nën hetim etj...

Neni 13

Bashkërendimi dhe koordinimi me institucionet e tjera

1. Prokurori në ushtrimin e funksioneve mund të bashkërendojë me oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe të shërbimeve në strukturat hetimore përkatëse në policinë e shtetit, dogana, tatime, njësinë e inteligjencës financiare dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese për koordinimin e veprimtarisë ndërmjet tyre:

- a) në fazën e gjurmimit të veprave penale, objekt i këtij udhëzimi, nëpërmjet konsultimit dhe koordinimit për kërkimin dhe vlerësimin e informacioneve dhe/ose indicieve për kryerjen e hetimeve proaktive dhe përdorimin e mjeteve të posaçme të hetimit;
- b) në fazën para referimit/kallëzimit nëpërmjet konsultimit e vlerësimit paraprak të materialeve objekt referimi apo kallëzimi penal lidhur me plotshmërinë e akteve/dokumentave që qartësojnë rrethanat e faktit dhe ekzistencën e elementeve të figurës së veprës penale përkatëse;
- c) në fazën e kryerjes së hetimeve dhe ushtrimit të ndjekjes penale nëpërmjet kryerjes së analizave të përbashkëta për kërkimin, gjetjen dhe administrimin e provave gjatë veprimtarisë hetimore, për vijimin e administrimit dhe dërgimit në Prokurorinë e Posaçme të provave dhe/ose indicieve të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën nga strukturat hetimore të shërbimeve të policisë gjyqësore përkatëse apo agjencitë ligjzbatuese të tjera.

2. Ushtrimi i kësaj veprimtarie bashkërenduese e koordinuese kryhet pa u cënuar pavarësia e prokurorit të përfshirë në ushtrimin e funksioneve të tij sipas kushtetutës dhe ligjit.

Neni 14

Bashkëpunimi me Organizatat Ndërkombëtare

1. Në kuadër të hetimit financiar dhe gjurmimit të produkteve të veprës penale, prokurori mund të kërkojë bashkëpunimin me organizata ndërkombëtare. Ndër këto organizata dhe rrjete ndërkombëtare mund të përmenden:

- a) Eurojust, ndihmon në koordinimin e hetimeve dhe ndjekjes penale ndërmjet autoriteteve të ndryshme gjyqësore brenda shteteve anëtare të Bashkimit Evropian në luftën kundër formave të rënda të krimit të organizuar ndërkufitar;
- b) Europol, ofron mbështetje analitike dhe informacione për hetimet që përfshijnë krime të ndërlikuara dhe të organizuara ndërkufitare, duke vepruar si një qendër për shkëmbimin e informacionit ndërmjet forcave të policisë në Evropë;
- c) Rrjeti CARIN (Camden Asset Recovery Inter-Agency Network), është një rrjet ndërqeveritar i dedikuar për gjurmimin e pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme, i cili lehtëson shkëmbimin e praktikave më të mira dhe të informacionit midis vendeve anëtare;
- ç) Interpol, ofron një platformë për shkëmbimin e informacionit të ndjekjeve penale dhe bashkëpunimin policor ndërkombëtar për të luftuar krimin e ndërlikuar ndërkufitar;
- d) AMON (Rrjeti Operativ Kundër Pastrimit të Parave (AMON), është një rrjet informal i krijuar për të lidhur dhe lehtësuar ndërveprimin dhe shkëmbimin e ekspertizës midis praktikuesve që punojnë në fushën e luftimit të pastrimit të parave;
- dh) BAMIN (Rrjeti Ndërinstitucional i Menaxhimit të Aseteve Ballkanike), është një rrjet joformal praktikuesish, që punojnë në mënyrë operative brenda Zyrave ose Agjencive të Menaxhimit të Aseteve, ose brenda institucionit ose departamentit të mandatuar për t'u marrë me menaxhimin dhe asgjësimin e asetëve kriminale në juridiksionin e tyre;
- e) SELEC (South East European Law Enforcement Center), promovon bashkëpunimin rajonal në luftën kundër krimeve ndërkufitare në Evropën Juglindore, duke përfshirë pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;
- ë) UNODC (Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin), ofron ndihmë teknike dhe mbështetje për të forcuar masat kundër krimit ndërkufitar dhe pastrimit të parave.

Neni 15

Kryerja e hetimit

1. Pas mbledhjes së informacionit nga burimet e hapura dhe nga bazat e të dhënave të institucioneve zyrtare, prokurori në respektim të kërkesave të K.Pr.P. për përdorimin e mjeteve të kërkimit të provës, kryen një ose disa nga veprimet hetimore të mëposhtme, në varësi të faktit nëse hetimit kryhet në kuadër të procedimit penal apo ligjit nr. 10192/2009:

- a) teknikat e posaçme të hetimit, të tilla si veprimet simuluese, infiltrimi në përbërje të grupit kriminal, dorëzimi i kontrolluar, përgjimi i komunikimeve, vëzhgimet;
- b) sigurimin me anë të letërporosisë i provave që gjenden jashtë vendit;

- c) sigurimin e provave kompjuterike, në respektim të dispozitave të procedurave penale;
- ç) kontrollin e transaksioneve financiare nëpërmjet ekspertizës kontabël, etj...;
- d) kontrollin, i cili përfshin kontrollin fizik të vendeve, objekteve, ose personave për të gjetur dhe siguruar prova mbi profilin financiar të individit, të tilla si:
 - i. dokumente mbi pasuritë e paluajtshme, automjetet ose pasuritë e tjera (dokumentet e pronësisë, faturat, kontratat tregtare dhe të sigurimit, kontratat e huasë dhe hipotekës, faturat e pagesës së interesit mbi llogaritë depozitë, faturat e pagesës së taksave, etj);
 - ii. çelësat e ndërtesave ose automjeteve;
 - iii. dokumentet mbi llogaritë bankare dhe kutitë e depozitave të sigurta;
 - iv. dokumente të kompanive tregtare;
 - v. pajisjet elektronike, duke përfshirë telefonat celularë, *smartphone*-t, tabletat, kompjuterët;
 - vi. pajisjet e ruajtjes së informacionit (karta memorie, *hard disk* etj.).
- dh) Marrja në pyetje e dëshmitarëve gjatë hetimit financiar për të marrë dëshmi, deklarata dhe informacione nga individë që mund të kenë njohuri rreth aktivitetit kriminal ose pasurive të fshehura. Dëshmitarët e marrë në pyetje mund të ndahen në tre kategori, si më poshtë:
 - i. Dëshmitarë të interesuar për rezultatet e hetimit, janë ata të cilët identifikohet nga personi i dyshuar, ose nën akuzë si burimi i fondeve ose pasurive;
 - ii. Dëshmitarë të përfshirë në mënyrë të dyshuar në krim janë ata individë, të cilët bazuar në disa burime, lidhen me veprën penale, por provat e mbledhura nuk janë të mjaftueshme për t'i kualifikuar këta individë si të dyshuar ose të akuzuar, ndërsa rrethanat objektive e bëjnë të domosdoshme pyetjen e tyre;
 - iii. Dëshmitarë palë të treta janë individët, që kanë dijeni mbi rrethana të caktuara të çështjes dhe mund të japin informacion në mënyrë objektive mbi faktet e hetuara.
- e) Marrja në pyetje e të akuzuarit, ose personit nën hetim me qëllim marrjen e deklaratave.
- ë) Formimi i Ekipeve të Përbashkëta Hetimore në rastet kur kryerja e hetimit kërkon angazhimin e burimeve nga vende të tjera ose në rastin kur dy apo më shumë vende kryejnë në mënyrë të koordinuar dhe të përbashkët hetime penale.
- f) Kryerja e analizave financiare nga hetuesit e SHF-së. Objekt i analizave financiare mund të jenë regjistri i librave të blerjes, regjistri i librave të shitjes, regjistrat kontabël, inventari, pasqyrat financiare, dokumente bankare, listë pagesa etj...

Neni 16

Provat digjitale

1. Prokurori dhe hetuesi përdorin teknika të avancuara dhe metoda specifike për marrjen, ruajtjen, analizimin dhe mbrojtjen e provave digjitale në respektim të K.Pr.P. me qëllim mbledhjen e provave në mënyrë të sigurtë, të plotë dhe të pandryshueshme. Shembuj të këtyre teknikave dhe metodave janë:

- a) Këqyrja digjitale, e cila konsiston në këqyrjen dhe analizimin e pajisjeve elektronike dhe

sistemeve kompjuterike për të gjetur, ruajtur dhe analizuar të dhënat digjitale. Kjo përfshin skanimin e hard diskut, analizën e sistemeve të llogarive elektronike dhe të dhënat e ruajtura në cloud.

- b) Përdorimi i teknologjive të enkriptimit për të mbrojtur të dhënat digjitale gjatë transmetimit dhe ruajtjes, duke siguruar që të dhënat të jenë të paaksesueshme nga persona të paautorizuar.
 - c) Krijimi i një kopje saktë të një memorie (klonimi), si për shembull një *hard disk* ose një kartë memorie, për të siguruar që të dhënat origjinale të mbeten të pandryshuara gjatë procesit të analizës.
 - ç) Përdorimi i mjeteve për të monitoruar dhe analizuar trafikun në rrjetet kompjuterike për të identifikuar veprimtari të dyshimta ose transaksione të paligjshme.
 - d) Teknikat që lejojnë dekodimin dhe analizën e mesazheve të enkriptuara për të zbuluar përmbajtje të fshehur ose informacione kyçe për hetimin.
 - dh) Programe kompjuterike të veçanta që janë zhvilluar për të ndihmuar në analizën e të dhënave komplekse, identifikimin e modeleve ose veprimtarive të dyshimta dhe nxjerrjen e informacioneve të rëndësishme nga baza të mëdha të të dhënave.
2. Çdo mbledhje e provave digjitale duhet të kryhet nga personel i trajnuar dhe i certifikuar në fushën e kibernetikës dhe sigurisë digjitale për të minimizuar rrezikun e dëmtimit ose ndryshimit të të dhënave.
3. Provat digjitale duhet të ruhen në mjedise të sigurta dhe të enkriptuara për t'i mbrojtur nga ndërhyrjet e paautorizuara dhe humbja e të dhënave.
4. Prokurori ose hetuesi duhet të krijojë rregullisht kopje rezervë (*backups*) të provave digjitale dhe t'i ruajnë ato në vende të ndryshme për të siguruar ruajtjen e tyre afatgjatë.
5. I gjithë procesi i mbledhjes dhe ruajtjes së provave digjitale duhet të dokumentohet hollësisht, duke përfshirë datën, orën, metodat e përdorura për mbledhjen dhe çdo veprim që është kryer me provat. Dokumentimi duhet të përfshijë gjithashtu identifikimin e personelit që ka kryer mbledhjen dhe ruajtjen e provave, si dhe çdo masë sigurie që është marrë gjatë këtyre proceseve.
6. Prokurori merr masa për të garantuar që aksesin në provat digjitale të lejohet vetëm për punonjës të autorizuar dhe në kontekste specifike të hetimit ose ndjekjes penale.

Neni 17

Dokumentimi i rezultateve të hetimit financiar

1. Në përfundim të veprimeve hetimore të nevojshme, hetuesi harton relacionin shpjegues për faktin dhe provat në përputhje me nenin 327 të K.Pr.P.. Relacioni shpjegues duhet të përmbajë, ndër të tjera, edhe informacion mbi:
- a) personin ndaj të cilit kryhen hetimet, cilësia (i pandehur, person nën hetim), të dhëna personale (vendbanimi, statusi martesor, punësimi, stili i jetesës);
 - b) pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, përfshirë vlerën dhe mënyrën e fitimit të pronësisë apo vënies në posedim, fondet e përdorura për këtë qëllim;
 - c) të ardhurat dhe shpenzimet, duke përfshirë llogaritë bankare, kutitë e depozitave të sigurta

- dhe transferimet financiare, për personin nën hetim apo familjarët e tij;
- c) përfshirjen në mosmarrëveshje ligjore dhe të ardhurat e deklaruar;
 - d) identifikimin e të ardhurave të fituara duke u bazuar në:
 - i. informacion nga deklaratat mbi pasuritë dhe interesat personale;
 - ii. informacion nga drejtoria e tatimeve mbi të ardhurat dhe dividendët e fituara;
 - iii. kur mundet, informacion nga institucionet përkatëse mbi raportet vjetore të paraqitura;
 - iv. informacion mbi organizimet familjare në të cilat subjekti mund të ketë mbledhur fonde (ditëlindje, dasma, pagëzime dhe ngjarje të tjera);
 - dh) pasuritë që ndodhen jashtë vendit dhe, kur është e nevojshme, shpenzimet e bëra jashtë vendit (udhëtime me familjen për pushime, blerjet e mallrave jashtë vendit etj.);
 - e) krahasimin dhe analizën e të dhënave financiare, përfshirë dallimet midis të ardhurave dhe shpenzimeve dhe evidentimin, sipas rastit, të dallimeve të mëdha midis të ardhurave dhe shpenzimeve të personit;
 - ë) pasuritë e sekuestruara përfshirë vendimin e sekuestrimit, datën e sekuestrimit dhe vendimet gjyqësore.
2. Relacionit shpjegues i bashkëlidhen lista e provave dhe dokumenteve që mbështesin rezultatet e hetimit financiar.

Neni 18

Ruajtja e sekretit hetimor, ndalimi i publikimit të akteve dhe mbrojtja e të dhënave personale

1. Në zbatim të këtij udhëzimi prokurorët, hetuesit e BKH-së dhe hetuesit e SHF-së të përfshirë në kryerjen e veprimeve hetimore marrin të gjitha masat për ndalimin e publikimit të akteve, për ruajtjen e sekretit hetimor, dhe mbrojtjen e të dhënave personale, duke respektuar detyrimet ligjore, si më poshtë:
- a) Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve sekrete që lidhen me çështjen ose dhe vetëm i përmbajtjes se tyre nëpërmjet shtypit ose informacionit masiv;
 - b) Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm i akteve josekrete deri në përfundimin e hetimeve paraprake;
 - c) Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm i akteve të shqyrtimit gjyqësor kur gjykimi bëhet me dyer të mbyllura. Ndalohet publikimi i gjeneraliteteve dhe i fotografive të të pandehurve dhe të dëshmitarëve të mitur, të akuzuar ose të dëmtuar nga vepra penale.
2. Aktet hetimore janë sekret derisa i pandehuri të mos ketë marrë dijeni për to.
3. Në rast nevojë për vazhdimin e hetimeve, prokurori mund të urdhërojë ruajtjen e sekretit dhe ndalimin e publikimit për akte të veçanta deri në përfundim të hetimeve. Urdhri shoqërohet me përpilimin dhe nënshkrimin e deklaratës për ruajtjen e sekretit hetimor dhe ndalimin e publikimit.

KREU V
SEKUESTRIMI, KONFISKIMI I PRODUKTEVE TË VEPRËS PENALE DHE
REKUPERIMI I DËMEVE

Neni 19

Sekuestrimi si mjet provues

1. Gjatë procesit penal, prokurori me iniciativë të vetë ose me kërkesë drejtuar gjykatës sipas parashikimeve të K.Pr.P. si dhe në raste urgjente edhe hetuesi, kur ka rrezik për humbjen ose ndryshimin e provave dhe nuk është e mundur të kontaktohet menjëherë prokurori, mund të urdhërojë sekuestrimin e pasurive si mjet i kërkimit të provës.
2. Sekuestrimi si mjet i kërkimit të provës urdhërohet ndaj pasurive që konsiderohen të rëndësishme për të shërbyer si prova materiale gjatë gjyqit. Kjo përfshin çdo send ose pasuri që mund të kontribuojë në sqarimin e rrethanave të çështjes penale.

Neni 20

Sekuestrimi si masë sigurimi pasuror

1. Sekuestrimi si masë sigurie mund të urdhërohet me qëllim dhe në formën e:
 - a) Sekuestrimit parandalues atëherë kur pasuria është e lidhur drejtpërdrejt me veprën penale dhe ekziston rreziku që disponueshmëria e saj mund të përkeqësojë pasojat e veprës penale ose të lehtësojë kryerjen e veprave të tjera penale. Pasuria e sekuestruar mund të përfshijë mjetet ose produktet e krimit.
 - b) Sekuestrimit konservativ i cili zbatohet në rastet kur i pandehuri nuk ofron garanci për pagesën e dëmeve financiare ndaj viktimave ose shtetit. Ky lloj sekuestrimi synon të sigurojë mbulimin e detyrimeve financiare dhe ndryshe nga sekuestrimi parandalues, përfshin vetëm pasuri me prejardhje të ligjshme.

Neni 21

Sekuestrimi në kuadër të Ligjit nr. 10192/2009

1. Në rastet kur gjatë kryerjes së hetimeve pasurore apo në përfundim të tyre rezultojnë pasuri për të cilat kërkohet aplikimi i masave pasurore parandaluese sipas ligjit nr. 10192/2009, prokurori vlerëson kushtet dhe kriteret ligjore për sekuestrimin e pasurisë dhe me kërkesë të arsyetuar i kërkon gjykatës sekuestrimin e pasurive, të ardhura në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në pronësi të plotë ose të pjesshme të personave/subjekteve sipas ligjit ose sekuestrimin e pasurive të barazvlefshme.
2. Sekuestrimi i pasurisë mund të zbatohet edhe për pasurinë tjetër përveç asaj që është e sekuestruar, madje edhe me prejardhje të ligjshme, në rast se pronari i saj i ligjshëm e transferon,

keqpërdor, shkatërron, fsheh ose zhvlerëson pasurinë që është sekuestruar, me qëllim që t'i shmangët ekzekutimit.

3. Sekuestrimi në zbatim të ligjit nr. 10192/2009 mund të zbatohet edhe kur pasuria fitohet pandershmërisht nga palët e treta, ose edhe në bazë të një marrëveshjeje të arritur ndërmjet prokurorit dhe të pronarëve të ligjshëm të pasurisë.

4. Policia gjyqësore, pasi kryen veprimet hetimore pasurore të nevojshme, pas konsultimit/vlerësimit paraprak me prokurorin ia dërgon aktet bashkë me një relacion shpjegues për rrethanat e faktit dhe provat/dokumentet si dhe me sugjerimet për masat parandaluese kundër pasurisë.

Neni 22

Raportimi

1. Prokurori, jo më vonë se 7 ditë nga zbatimi i sekuestros, raporton në zyrën e Regjistrisë të dhëna në lidhje me vendosjen e masave të sigurimit pasuror dhe, në rastet kur nuk çënohet sekreti hetimor, duke vënë në dispozicion kopje të vendimit të gjykatës që ka caktuar masën e sigurimit.

Neni 23

Konfiskimi

1. Në përfundim të gjykimit të çështjeve penale për vepra penale prej të cilave janë përftuar pasuri/asete produkte të veprës penale, mbi të cilat është vendosur apo jo sekuestrimi, prokurori kur vlerëson se ekzistojnë kushtet/kriteret ligjore, në konkluzionet përfundimtare i kërkon gjykatës konfiskimin e produkteve të veprës penale dhe/ose të çdo pasurie, vlera e së cilës i korrespondon asaj të produkteve të veprës penale sipas përcaktimeve të nenit 36 të Kodit Penal.

2. Në përfundim të hetimeve të procedimit pasuror prokurori vlerëson dhe vendos:

a. kërkimin në gjykatë të konfiskimit të pasurisë kur vlerëson se:

- i. ekziston dyshimi i arsyeshëm, duke u bazuar në indicie, për pjesëmarrjen e një personi në aktivitete kriminale të parashikuara në nenin 3, pika 1, të ligjit nr. 10192/2009;
- ii. rezulton se pasuria është, drejtëpërdrejtë ose tërthorazi, në zotërim të plotë apo të pjesshëm të personave të përmendur në nenin 3, pika 1, të ligjit nr. 10192/2009;
- iii. nuk provohet se pasuria ka prejardhje të ligjshme, apo personat e përmendur në nenin 3, të ligjit nr. 10192/2009, nuk arrijnë të përligjin zotërimin e pasurive ose të ardhurave, të cilat janë shpërpjestimore me nivelin e të ardhurave apo fitimeve të realizuara nga burime të ligjshme të deklaruara prej tyre.

b. pushimin e hetimit pasuror në rastet kur:

- i. nuk rezultojnë pasuri ndaj të cilave mund të aplikohen masat ndaj pasurisë

që parashikon ligji nr. 10192/2009;

- ii. vlerëson se nuk ka indicie dhe/ose akte/dokumente që evidentojnë kushtet dhe kriteret për të kërkuar konfiskimin e pasurisë.

3. Në rastet kur pas arkivimit të materialit referues pasuror ose pas mosfillimit të procedimit pasuror, zbulohen ose dalin të dhëna të reja për pasuri të tjera të subjekteve të masave parandaluese, të panjohura më parë apo të krijuara më vonë, prokurori pasi vlerëson provat apo të dhënat e reja, sipas rastit mundet që të vendosë:

- a) Regjistrimin e referimit pasuror dhe kryerjen e verifikimeve pasurore;
 - b) Revokimin e vendimit për mosfillimin e procedimit pasuror dhe vazhdimin e mëtejshëm të verifikimeve pasurore;
 - c) Revokimin e vendimit për pushimin e procedimit pasuror dhe rifillimin e hetimit pasuror.
4. Para vendosjes së konfiskimit të një sendi ose pasurie me natyrë specifike që paraqesin sfida për administrimin dhe ruajtjen e vlerës së tyre prokurori mund të konsultohet me Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK).

KREU VI

DISPOZITA TË TJERA

Neni 24

Forcimi i kapaciteteve profesionale

1. Prokurorët, në kuadrin e trajnimit vazhdues, sipas nevojës mund të propozojnë ose planifikojnë me përparësi trajnime me tema në fushën e pastrimit parave, krimeve financiare, financimin e terrorizmit dhe hetimeve pasurore, për forcimin e kapaciteteve profesionale të tyre.
2. Në kuadrin e trajnimeve të përbashkëta, këto prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore që ushtrojnë funksionet pranë tyre përfshihen në aktivitetet trajnuese me oficerë të policisë gjyqësore të strukturave përkatëse hetimore në policinë e shtetit, dogana, tatime, dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese, dhe jo vetëm, me tema lidhur me analizën e riskut, gjurmimin, verifikimin, hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e veprave penale të pastrimit të parave, krimet financiare, financimin të terrorizmit dhe hetimet pasurore, me synim forcimin e kapaciteteve profesionale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimeve financiare, financimin e terrorizmit dhe sekuestrimin e konfiskimin e aseteve dhe të ardhurave kriminale.
3. Prokurorët, hetuesit e BKH-së dhe hetuesit e SHF-së mbajnë takime të përbashkëta çdo tre muaj për të ndarë përvojat, sfidat dhe mësimet të fituara gjatë ushtrimit të detyrave të tyre në fushën e hetimeve pasurore dhe financiare.

Neni 25

Zbatimi dhe mbikëqyrja

1. Ky udhëzim i përgjithshëm është i detyrueshëm për zbatim nga prokurorët, hetuesit e BKH-së dhe hetuesit e SHF-së.
2. Prokurorët, hetuesit e BKH-së dhe hetuesit e SHF-së konsultojnë manualin me titull “Goditja e aseteve kriminale”. Një manual gjithëpërfshirës mbi pastrimin e parave dhe rekuperimin e aseteve. Kuadri ligjor shqiptar dhe ndërkombëtar” i vitit 2024¹, për t’u orientuar rreth zbatimit në praktikë të këtij Udhëzimi.
3. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ngarkohet me mbikëqyrjen e zbatimit të këtij udhëzimi.


Neni 26

Hyrja në fuqi dhe publikimi

1. Ky udhëzim i përgjithshëm për efekte të masave organizative dhe administrative përgatitore hyn në fuqi menjëherë.
2. Ky udhëzim i përgjithshëm publikohet në faqen e internetit të Prokurorisë së Posaçme.

DREJTUESI I PROKURORISË

ALTIN DUMANI



¹ Manuali mund të konsultohet në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme këtu:

https://www.pp.gov.al/rc/doc/Targeting_criminal_assets_AL_7413.pdf

SHTOJCË

Lista e Bazave të të Dhënave Shtetërore të Vlefshme për Hetimin Financiar

1. Sistemi i deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesit – EACIDS.
2. Arkivi digjital i arkivit qendror teknik të ndërtimit.
3. Sistemi i menaxhimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore (CMIS).
4. Sistemi i menaxhimit të bordit dhe analizës financiare (SMBAF).
5. Sistemi i arkivimit dhe menaxhimit të dokumenteve të vjetërsisë në punë dhe periudhave të sigurimit (DMAIS).
6. Sistemi i vlerësimit të Maturës Shtetërore.
7. Sistemi informatik financiar i qeverisë (SIFQ).
8. Regjistri Elektronik Shëndetësor Kombëtar.
9. Regjistri Elektronik i Subjekteve Kontrolluese.
10. Sistemi i Integruar Bibliotekar DATABKSH.
11. Sistemi i menaxhimit, Kalkulimit të Pagesës së Përfitimit (PCAMS).
12. Databaza Gjeografike për Regjistrimin e Aktivitetit në Terren të ASHA-s.
13. Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP).
14. Baza e të dhënave shtetërore të Sistemit të Provimit të Shtetit (SPSH).
15. Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Denoncimeve për Rekordet Korruptive” (këtu e në vijim “SEMDRK”).
16. Regjistri i ofruesve të shërbimit inovativ dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive të automatizuara”.
17. Regjistri i të dhënave të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to”
18. Regjistri elektronik i ekspertëve, i përkthyesve zyrtarë dhe interpretëve të gjuhëve të shenjave”.
19. Sistemi i Shërbimeve të Punësimit (SSHP).
20. Sistemit të Programit të Buxhetit Afatmesëm (SPBA).
21. Sistemit informatik të menaxhimit financiar (SIMF).
22. Baza e të dhënave shtetërore për hartën dixhitale të venddepozitimeve të mbetjeve urbane (shkurtimisht “HDVMU”).
23. Baza e të dhënave shtetërore të Shërbimit Noterial Shqiptar, të quajtur Regjistri Noterial Shqiptar (RNSH).
24. “Regjistri elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit” (në vijim “REKPDI”).
25. Baza e të dhënave shtetërore të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë
26. Baza e të dhënave shtetërore për trafikun detar.
27. Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)”.
28. Baza e të dhënave shtetërore për sistemin elektronik të lejeve (sistemi e-Leje), për të gjitha kërkesat dhe lejet, sipas legjislacionit të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit.
29. Baza e të dhënave shtetërore “Portali unik qeveritar e-Albania”.